



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 113
Prishtinë, më 10 qershor 2010

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 10 QERSHOR 2010**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ai propozoi edhe një pikë shtesë: Ratifikimi i Marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për financimin e Projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e Projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi propozimin e Kryetarit.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Ratifikimi i Marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për financimin e Projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e Projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e Emblemsë së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik,
9. Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009,
10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2009.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës u paraqitën këta deputetë: **Gani Geci, Flora Brovina, Gjylnaze Sylja, Ibrahim Makolli, Ramadan Avdiu, Driton Tali, Numan Baliq, Besa Gaxheri, Nait Hasani dhe kryeministri Hashim Thaçi**, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Miratimi i Procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës plenare, të mbajtur më 27 maj 2010, u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Abdyl Ymeri** parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, lidhur me definimin e qartë të vijës kufitare Kosovë - Mali i Zi

Ministri **Rexhepi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Ymeri.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, lidhur me shitblerjen e vagonëve të Hekurudhave të Kosovës.

Ministri **Rexhepi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Basri Musmurati** parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Jashtme, Skënder Hyseni, lidhur me deklaratimet e zyrtareve të kësaj ministrie në gazetatat ditore për performancën e ambasadorëve të Republikës së Kosovës në botë.

Ministri **Hyseni** iu përgjigj pyetjes së deputetit Musmurati.

Deputeti **Naim Rustemi** parashtroi pyetje për zv. kryeministrin Hajredin Kuçi lidhur me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ nga ana e Qeverisë së Kosovës për zbatimin e Ligjit për prokurimin publik.

Zv. kryeministri Kuçi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me çmimin e lartë për importimin e energjisë elektrike.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kanë shqyrtuar Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, për miratim.

Raportin e komisionit përgjegjës raportues, para deputetëve të Kuvendit e arsyetoi kryetari i komisionit, **Sadik Idriz**.

Pastaj, kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1 (a), 2 (a), 3, 4(a), 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Në fund, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 64;
Kundër----- 3.
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e Emblems së Kryqit të Kuq, të emblemeve të tjera dalluese dhe të sinjaleve

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kanë shqyrtuar Projektligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e Emblems së Kryqit të Kuq, të emblemeve të tjera dalluese dhe të sinjaleve dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, për miratim.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi miratoi amendamentet: 2, 3, 4 dhe 5.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin 1.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 58;
Kundër----- 6.
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e Emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion kanë shqyrtuar Projektligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime, për miratim.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 70;
Kundër----- 1.
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion kishin shqyrtuar Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik dhe Kuvendit ia kishin paraqitur raportet me rekomandime, për miratim.

Raportin e komisionit përgjegjës raportues, para deputetëve të Kuvendit e arsyetoi deputetja Nerxhivane Dauti.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 65;
Kundër----- 1.
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik.

8. Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Raportin financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009.

Ministri **Ahmet Shala**, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës tha se Raporti financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës është i bazuar në Ligjin e financave publike nr. 03/L-048.

Në vazhdim, ministri Shala paraqit më hollësisht konstatimet e raportit, siç janë: ngritja substanciale e nivelit të të hyrave, rritja e investimeve kapitale, pastaj fakti se përkundër rritjes së numrit të institucioneve të reja, rritja e shpenzimeve është mjaft simbolike, rritjen e realizimit të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, e cila ka qenë për 22 % më e madhe në krahasim me vitin paraprak etj.

Më tutje, ministri paraqiti një vistër parametrash financiar të Raportit për vitin 2009, krahasuar me ata të vitit 2008, siç janë: të hyrat e arkëtuara në kufi kapin shumën e 55 % të shumës totale, të hyrat nga Administrata Tatimore janë 16 % , të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm janë 4%, të hyrat vetanake të nivelit qendror janë 3 %, të hyrat nga dividendat e PTK-së janë 200 mijë €.

Në kohën kur në shumë shtete në Evropë dhe më gjerë, kemi një ulje të të hyrave, vendi ynë e ka përballuar me sukses këtë sfidë, më mirë se sa shumë shtete në rajon dhe më gjerë, tha ai.

Ai përmendi edhe shumën e paguar prej mbi 170 milion € për anëtarësimin e Kosovës në Bankën Botërore, ku nga buxheti shtetëror janë dhënë mbi 43 milion €, kurse pjesën tjetër për këtë qëllim e ka mbuluar SHBA-ja, në shumën mbi 84 milion €, BE-ja 5 milion €, të cilat i falënderoi publikisht për ndihmën e ofruar Republikës së Kosovës.

Qeveria e Kosovës në vitin 2009 në emër të kredisë së KEK –ut, ka paguar shumën prej 78 milion €, theksoi ministri.

Më tutje, ai potencoi se raporti është tregues i qartë se institucionet e vendit janë në rrugë të forcimit të vazhdueshëm shtetëror dhe se ky raport pasqyron realizimin e plotë të objektivave dhe të kualitetit qeverisës në menaxhimin e financave publike.

Në fund, ministri Shala i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë këtë raport.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajdin Abazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulëzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Rexhep Hoti, Gjylnaze Sylja, Armend Zemaj, Driton Tali, Ramadan Avdiu, Berim Ramosaj, Naim Rustemi, Mimoza Ahmetaj, Basri Musmurati, Ibrahim Gashi, Gani Buçinca, Abdyl Ymeri dhe ministrat Fehmi Mujota dhe Ahmet Shala, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----44,

Kundër-----9,

Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009.

9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2009

Kryetari ftoi përfaqësuesin e komisionit funksional që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë raportin, me rekomandime.

Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, **Haki Shatri**, tha se raporti të cilin po e shqyrtojmë është i përgatitur mirë dhe i plotëson standardet e raportimit, sipas Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është një institucion me rëndësi të veçantë për vendin tonë dhe performanca e saj në të ardhmen duhet të rritet akoma më shumë. Ai theksoi se në favor të rritjes së kësaj performace shpreson se do të jetë edhe rritja e numrit të auditorëve të rinj edhe për 30 zyrtarë.

Deputeti Shatri, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, kërkoi mbështetje më të madhe për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, si në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës, por edhe të mbështetjes financiare.

Deputeti Shatri shtroi edhe çështjen e inicimit të procedurës së ndryshimit të Ligjit për ndërmarrjet publike, në kapitullin që ka të bëjë me auditimin e këtyre ndërmarrjeve.

Në emër të komisionit funksional, ai kërkoi nga deputetët miratimin e raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Rexhep Hoti, Naim Rustemi, Driton Tali dhe Ismet Beqiri, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55,
Kundër-----1,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi Raportin punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI